



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – URED PREDSEDNIKA

KËSHILLI KOMBËTAR PËR INTEGRIM EVROPIAN

Shtojca 1

Përfundimet dhe rekomandimet e takimit të pestë **07 tetor 2013, Prishtinë**

1. Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian miraton Strategjinë Kombëtare për Integrim Evropian, “Kosova 2020: një qasje gjithëpërfshirëse.” Këshilli vlerëson angazhimin dhe kontributin e të gjithë pjesëmarrësve nga institucionet, partitë politike, shoqërisë civile, komunitetit akademik e të biznesit dhe ekspertëve të fushave të ndryshme, për kontributin e dhënë në procesin e hartimit të strategjisë.
2. Të ndërmerren hapat bashkërendues që të gjitha strategjitë dhe dokumentet sektoriale të kontribuojnë në arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Integrim Evropian.
3. Objektivat e Strategjisë Kombëtare për Integrim Evropian të adresohen përmes rishikimit të Planit të Veprimit për Marrëveshjen Stabilizim-Asociimit.
4. Është me rëndësi që gjatë periudhës së negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, qytetarët, dhe në veçanti sektori privat, të jenë të informuar për ndikimin e reformave të MSA-së.
5. Të diskutohet mënyra e njoftimit dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile për mbarëvajtjen dhe procesin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.